



RESTORANTI MEYER

Kur ushqimi ndihmon kurimin

Ushqimi për fëmijët dhe adoleshentët e shtruar në spital

Në shtëpi, në shkollë ose me pushime, mëngjesi, dreka dhe darka janë momente të rëndësishme, ato i japin ritëm ditës dhe kanë një efekt qetësues.

Në spital, vakti merr një kuptim të veçantë sepse ushqimi është pjesë përbërëse e kurimit.

Ushqimi i duhur është një faktor i jashtëzakonshëm shëndetësor dhe karakteristikat ushqyese të ushqimeve bëhen një "përbërës" i çmuar në procesin e shërimit.

Në prani të patologjive të veçanta, ndërhyrja ushqyese merr qëllime terapeutike specifike dhe mund të ndihmojë në parandalimin e komplikimeve.

Për këto arsye ne i kemi kërkuar kompanisë që siguron ushqim për repartet dhe për mensën që të përdorin produkte cilësore, origjina e të cilëve mund të gjurmohet, duke favorizuar ushqimet sezonale dhe organike. Në fakt, menuja përfshin ushqime të freskëta, të ngrira ose organike.

Kur dieta është e lirë, është e mundur të zgjidhni duke u bazuar në menu, por nëse është e nevojshme të ndiqni një dietë të veçantë, dietologu i Meyer-it ndërhyr dhe shpjegon pse disa ushqime janë më të preferueshme se të tjerat.

Ne përqëndrohemi në vlerën edukative të gatimit spitalor, në cilësinë e shërbimit, në vlefshmërinë ushqyese të vaktit, në respektimin e kulturës ushqyese lokale dhe padyshim në kënaqësinë e shijes, prandaj

Ju bëftë mirë!

Drejtoria

Ushqimi për prindërit dhe/ose shoqëruesit

- Shërbimi i shpërndarjes së vakteve (**shporta**) është në dispozicion për prindin / shoqëruesin nga stafi i mensës, drejtpërdrejt në repart.
- Për të pasur këtë shërbim është e nevojshme të blini kuponët e vaktit në arkën e mensës, çdo ditë, nga ora 10.45 në 11.45 dhe nga 14.45 në 15.30.
- Kostoja e vaktit është 5.00 euro.
- Mund të blihen më shumë kuponë dhe kuponët e papërdorur mund të rimbursohen direkt në arkën e mensës.
- Shporta përbëhet nga dy pjata sipas dëshirës tuaj, ujë, bukë dhe fruta.



- Stafi i mensës shpërndan shportën në repart tek prindi / shoqëruesi pas dorëzimit të kuponit.

Duhet kujtuar që

Ushqimet e konsumuara në repart duhet të paguhen duke blerë më parë kuponët e ushqimit në arkën e mensës.

Orët e hapjes së arkës për blerjen e kuponëve janë si më poshtë: çdo ditë nga e hëna në të shtunë nga 10.45 në 11.45 dhe nga 14.45 në 15.30.

1 Tetor 2021